



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/33

Datë: 19.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/27 të datës 30.04.2020 për emërimin e anëtarëve të Këshillit Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1, paragrafi 1.5 i vendimit të Qeverisë nr. 10/27 të datës 30.04.2020, si në vijim:
- 1.5. Në vend të z. Arben Mehmeti, anëtar, emërohet z. Imer Rusinovci nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë-FBV.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit të Qeverisë 10/27 të datës 30.04.2020.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/33

Datë: 19.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/19, datë 30.03.2020, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 06/25, datë 17.04.2020

1. Në pikën 1, nën pika 1.4. e Vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale, i datës 30.03.2020, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 06/25, i datës 17.04.2020, ndryshohet si në vijim:

1.4. Subvencionimi i ndërmarrjeve publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, në vlerë deri në njëzetë milion (20,000,000.00 €) euro.

2. Në pikën 1, pas nën pikës 1.4. e Vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale, i datës 30.03.2020, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 06/25, i datës 17.04.2020, shtohet nën pika me numër rendor 1.4.1, me tekstin si në vijim:

1.4.1. Subvencioni i caktuar sipas pikës 1.4. të këtij vendimi mund të jetë i kushtëzuar dhe të reduktojë ndarjet buxhetore për vitin aktual apo vitet vijuese fiskale për ndërmarrjet publike përfituese nga pika 1.4. e këtij Vendimi.

3. Mjetet për zbatimin e kësaj mase sigurohen nga buxheti ekzistues i Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, kategoria e subvencioneve.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/33

Datë: 19.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020 - 2024.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2020 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Integritimit Evropian dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit.
4. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të inkorporojë në Program të gjitha komentet e Komisionit Evropian.
5. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që gjatë vitit 2020 të inkorporojë në Program veprimet pasuese të dala nga konkluzionet e takimeve të raundit të dytë të organeve të Stabilizim-Asociimit të themeluara me MSA.
6. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të përcjellë këtë Program për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/33

Datë: 19.05.2020

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (CEB) për financimin e projektit "Reagimi Emergjent ndaj COVID-19".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë